

NE MITROVICE U MBAJT SEMINAR LIDHUR ME STRATEGJINE EKONOMIKE PER KOSOVEN

KOSOVA NUK MUND TE ZHVI- LLOHET PA NDIHME NGA JASHTE

Ministri per Ekonomi dhe Financa, Ali Sadiu, tha se Kosoven vetem privatizimi mund te shpie me vrullshem drejt ekonomise se qendrueshme te tregut.

Mitrovice, 75 korrik

Grupi per Strategji Ekonomike dhe Identifikim te Projekteve (ESPIG), ne bashkepunim me Iniciativen per Stabilitet ne Evrope (ESI), duke u perkrahur nga Departamenti per Zhvillim Nderkombetar (DFID), ka organizuar te enjten; nje seminar ne Hotelin "Pallace" ne Mitrovice, ne te cilin eshte diskutuar per vizionin ekonomik te Kosoves. Ne seminar, perveq te tjereve, moren pjese edhe kryeministri i Kosoves, Bajram Rexhepi dhe Ministri per Ekonomi e Financa, Ali Sadriu.

Kryeministri i Kosoves, Bajram Rexhepi, vleresoi me ke'te rast se hartimi i nje strategjie dhe identifikimi i prioriteteve per te ardhmen e zhvillimit ekonomik te Kosoves eshte nje ceshtje e ngutshme, meqe Kosova gjendet ne nje situatë shume delikate. Duke folur per gjendjen e rende ekonomike, kryeministri Rexhepi ka thene se Kosova ka renie drastike te donacioneve dhe ajo nuk mund te zhvillohet pa ndihme nga jashte. Nderkaq, Ali Sadiu, ministri per Ekonomi dhe Financa, ka thene se Kosoven vetem privatizimi mund

te shpie me vrullshem drejt ekonomise se qendrueshme te tregut, kurse duke folur per strategjine, ai vleresoi se Kosoves i mungojne shume parakushte per nje strategji per cka duhet te kete kornize te zhvillimit ekonomik. Organizatoret e seminarit, Gernard Knaus dhe John Bradley, nga ESI, paraqiten edhe nje draft per diskutim per vizionin ekonomik dhe vleresuan se ne mungese te nje strategjie realiste te zhvillimit, gjendja e tanishme e rende ekonomike sigurisht se do te perkeqesohet dhe, me tej, BSM